

Suksese artistësh tanë jashtë vendit: Elina Duni, këngëtare xhazi

Me secilin tingull të kujton rrënjët e saj shqiptare

Elina këndon me një intensitet të tillë sa të duket se do ta përqafojë gjithë botën. Ndonëse kuarteti i ofron një mbështetje dinjitoze dhe profesionale, ylli i pakontestueshëm i mbrëmjes dihet kush është: Elina Duni! Me interpretimet e këngëve popullore shqipe, me rrezatimin e saj aspak të shtirur, Elina Duni krijon një atmosferë e cila me secilin tingull të kujton rrënjët e saj shqiptare.

"Lulja magjike nga Ballkani", kështu e kanë quajtur gazetaret gjermane Elina Dunin, këngëtare e talentuar shqiptare të xhazit e cila prej rreth 15 vitesh jeton në Zvicër. Javën që po ikën, Elina ka mbajtur disa koncerte në qytete të ndryshme të Gjermanisë. Mes tjerash edhe në Darmstadt dhe Reutlingen. Gazetat e këtyre qyteteve dhe ato të regjionit nuk e lëshojnë këtë rast pa bërë disa shkrime në të cilat nuk kursejnë komplimentet për këngëtare tonë. "Një bareshë që e njih edhe vetminë e qytetit", shkruan njëra ndër gazetaret duke i referuar këngës mbase më kumbuese të këngëtares sonë, asaj me titullin "baresha", emrin e të cilës e bart edhe cd-ja e saj, e publikuar rishtas.

"Të mërkurën në Darmstadt ishte mysafir kuarteti i Elina Dunit nga Zvicra. Kjo këngëtare, së bashku me të emën kishte emigruar nga Shqipëria në Gjenevë, kur ajo ishte vetëm 11 vjeçe. Në këtë qytet ajo ka studiuar pianon klasiq në "Conservatoire de Musique de Genève" dhe në "Collège de Saussure", por gjatë asaj kohe ka zbuluar edhe pasionin e saj për xhazin. Në metropolet si Nju Jorku, ajo është njohur me vetminë e qyteteve të mëdha, ndërsa me kthimin në Zvicër, në vitin 2004, Duni iu kushtua vetëm xhazit, duke krijuar kuartetin e saj me pianistin Colin Vallon, basistin Bänz Oester dhe bateristin Norbert Pfammater. Në albumin e saj aktual "Baresha" (të titulluar në origjinal pra, në shqipe, v.j.) ashtu si dhe në paraqitjen e saj në koncertin e mbajtur në institutin e



Elina Duni

Si Edit Piaf...

Nganjëherë artikulli i saj të kujton portugezen Maria Joao, e herë herë edhe këngëtare e paharrueshme Edit Piaf. Pastaj sërish prej saj shpërthejnë tinguj të një tijejhereje të shkujdesur.

Darmstadtit, Elina Duni na bindi me meloditë e saj, të shumtën e rasteve të përcjella vetëm me gojë (vokal) nga folklori i qëmtuar gjithandë nëpër Ballkan. Këngët si "Lule", e cila bën fjalë për një lule që shndërrohet në flutur dhe prandaj bëhet e pakapshme, ose kënga "Qiparisin" etj. të imponohen me shprehjen e thellë dhe të fuqishme.

Krahas këngëve, melodive e ritmeve shqiptare, greke dhe bullgare, në repertorin e Elinës bëjnë pjesë edhe këngët e ikonave të shansonës frënge Serge Gainsbourg dhe Leo Ferre, melankolike dhe shumë të përmbajtura. Ndërkaq, nga zhur-

mërimat, tonet e tingujt burojnë edhe këngë gazmore e të gjalla si kënga "Baresha", që ka burimin nga Kosova... përfundon shkrimi në faqen e internetit nga Darmstadt, "Echo online".

Ngjashëm dhe me komplimente për këngëtare shqiptare Elina Duni shkruan edhe gazeta "Reutlinger general Anzeiger". "Zëri i saj përmban temperance dhe ekspresivitet. Nganjëherë artikulli

i saj të kujton portugezen Maria Joao, e herë herë edhe këngëtare e paharrueshme Edit Piaf. Pastaj sërish prej saj shpërthejnë tinguj të një tijejhereje të shkujdesur. Ajo ka një zë që të ngrit mornicat në lëkurë dhe që shtyn publikun të lëviz gishtërinjtë...

27 vjeçja, bartëse e bursës "Friedl-Wald" këndon me një intensitet të tillë sa të duket se do ta përqafojë gjithë botën. Ndonëse kuarteti i ofron një mbështetje dinjitoze dhe profesionale, ylli i pakontestueshëm i mbrëmjes dihet kush është: Elina Duni!, nënvizon gazeta. Ajo i takon atij soji të këngëtareve të cilat ia dalin që në mënyrë të mrekullueshme dhe në dukje, pa problem, të lidhin bashkë përmbajtjen, rrezatimin dhe muzikën. Me interpretimet e saj më shumë tradicionale të këngëve popullore shqipe, me rrezatimin e saj aspak të shtirur, Elina Duni krijon një atmosferë e cila me secilin tingull të kujton rrënjët e saj shqiptare. (B.SH.)

Më 31 maj në Gaillard, Francë

Ekspozitë personale e piktorit Gani Bytyçi

Ditën e shtunë, më 31 maj në Annemasse të Francës (lokaliteti Gaillard) që gjendet në afërsi të kufirit me Zvicrën, piktori ynë Gani Bytyçi, hap ekspozitën e tij personale të radhës me piktura. Në solemnitetin e hapjes, disa pika muzikore me piano do të ekzekutojë Ermira Zyrakja-Lefort, pianiste e jona e njohur me qëndrim në Gjenevë. Me fjalën e hapjes dhe me një vlerësim për ekspozitën do të paraqitet piktorja dhe korrespondentja e gazetës franceze "Dauphine libere" Graziella Delaroché.

Kjo ekspozitë do të hapet në lokalitetin "Pianos Croces" që gjendet në 2 rue de Jura në Gaillard.

Solemniteti i hapjes së ekspozitës (vernissage) fillon në orën 17.00 ndërsa ekspozita mund të vizitohet deri më 28 qershor, çdo ditë nga e marta deri të shtunë; paraditeve nga ora 10 deri në orën 12 dhe pasditeve nga ora 14 deri në orën 19.00.



KONKURS

Mësimdhënës për ciklin e ulët, mësimi plotësues në klubin "Oda Shqiptare", Berlin

DETYRAT E PUNËS:

Kandidati duhet të ketë njohuri për të siguruar planifikimin, përcjelljen, zhvillimin dhe avancimin e mësimi plotësues në Berlin. Zhvilloni mësimin plotësues në gjuhën shqipe, ruan kontinuitetin e arsimit shqiptar në Berlin, bashkëpunon me shoqatën Shkëndija. Planifikon dhe organizon strukturën arsimore të nivelit cikli i ulët, por nëse është nevoja edhe ciklit të mesëm, bashkërendon, planifikon, zhvillon dhe mbikëqyr jetësimin e metodologjive themelore dhe të programeve lëndore, objektivat dhe synimet e mësimdhënies të miratuara nga Ministria e Republikës së Kosovës, departamentit për Diasporë. Bën kontrollimin profesional të cilësisë mësimore në paralelen e vet, bashkëpunon me trupat e tjera të shoqatës si dhe, këshillon, planifikon dhe miraton, zgjedh pikat programore, në manifestime për festat zyrtare dhe kombëtare të Kosovës dhe kombit shqiptar. Zbaton plan-programet mësimore, nxit lidhjen e prindërve, informon ata për ecurinë e mësimi. Kualifikimet arsimore dhe profesionale:

Diploma universitare (parapëlqehet diploma e universiteteve perëndimore) ose diplomë universiteti të Kosovës në drejtimet, gjuhë shqipe, dhe degët shoqërore. (Njohja e mirë e gjuhës gjermane e domosdoshme).

(aftësitë dhe përvojë në arsim e mirëseardhur). Kandidati duhet të ketë njohuri për të siguruar planifikimin, përcjelljen, zhvillimin dhe avancimin e mësimi plotësues në Berlin. Shoqata Shkëndija mirëpret aplikimet edhe nga femrat dhe meshkujt e të gjitha trojeve tona etnike për mësimdhënie. Me rastin e konkurrimit të interesuarit me vete duhet të sjellin diplomën origjinale në shikim, ndërsa kopja mbetet sepse dokumentet nuk kthehen.

Aplikacionet

Dokumentet e pakompletuara do të merren në shqyrtim në raste të veçanta, për një periudhë tre mujore. Aplikacionet e plotësuar duhet të dorëzojnë tek shoqata për Arsim Kulturë dhe Sport "Shkëndija" në Berlin. Afati për dorëzimin e kërkesave është nga dita e Enjte 28.05.2008 ose nga dita e shpalljes së konkursit në gazetë. Kandidatët do të intervistohen menjëherë pas mbylljes së konkursit nga udhëheqësit e shoqatës "Shkëndija". Për intervistë do të ftohen vetëm kandidatët e zgjedhur që hyjnë në listën e ngushtë.

Adresa: Shoqata Shkëndija

Hohenstaufenstr. 59

10781 Berlin

Tel. : 030/ 210 15 740

Fax.: 030/ 213 57 58

E-Mail: sh-shkendija@web.de

E pame për Maxhun (Mon) Murselin

Me rastin e vdekjes së papritur të babit tonë Maxhun (Mon) Murseli, të dielën, më 1. 6. 2008 nga ora 8:00 deri në orën 19:00 Familja Murseli pret për ngushëllime në Chemin de la Méléé (afër Migrosit), 1860 Aigle Për informata në tel: 079 425 85 10

Bisedë me studentin Kreshnik Myftari, udhëheqës i uebfaqes semester-books.de

"Edhe ne dimë", ose studentët shqiptarë në rrugë të suksesit

Të bëhesh student i njohur dhe i dalluar në një vend perëndimor, nuk është aspak e lehtë. Por kjo barrierë mund të quhet e tejkaluar qysh moti për disa studentë shqiptarë. Rreth kësaj dhe çështjeve tjera, flasim me studentin Kreshnik Myftari, i cili veç studimeve në Universitetin e Heidelbergut është i angazhuar edhe në disa aktivitete tjera. Projekti për huazim të librave universitarë përmes internetit, e ka bërë atë posaçërisht të njohur...

Elife Kurteshi

Zëri i Ditës: Kush është Kreshnik Myftari. Ju lutem, na tregoni diç për veten

Kreshnik Myftari: Unë jam nga Peja. Së bashku me familjen time kam ardhur në Gjermani si refugjat lufte në vitin 1999. Isha 14 vjeçar dhe e kisha të kryer shkollën fillore. Me shkollë fillore të kryer në gjuhën shqipe dhe pa njohuri të gjuhës gjermane, e kam pasur vështirë të integrohem në sistemin shkollor. Përzgjedhja e nxënësve këtu bëhet qysh në shkollën fillore çka do të thotë se më është dashur të kaloja prej nivelit më të ulët shkollor deri në nivelin që e lejon studimin. Tani jam i regjistruar në fakultet, po i ndjek studimet në semestrin e katërt për ekonomi dhe politikë në Universitetin e Heidelbergut.

Zëri i Ditës: Na trego, se çfarë është www.semester-books.de?

Kreshnik Myftari: Semester-Books.de është një treg interneti i librave të përdorur studentorë. E veçanta e Semester-Books.de është, se çdo fakultet e ka tregun e vet kështu që studentëve të një fakulteti u lehtësohet që të kontaktojnë dhe të tregtojnë në mes veti.

Zëri i Ditës: Nga të erdhi ideja që ta krijosh këtë uebfaqe?

Kreshnik Myftari: Ideja më ka lindur në fillim të studimeve, duke



Kreshnik Myftari

menduar se si të furnizohem më lehtë dhe më lirë me literaturë studentore.

Zëri i Ditës: Kush të përkrahu në realizimin e faqes?

Kreshnik Myftari: Realizimin e uebfaqes e bëra në bashkëpunim me dy shokë gjermanë, Alexander Pelz dhe Dominic Roessman- dy studente të cilët i kam njohur gjatë studimeve.

Zëri i Ditës: Si ia filluat punën?

Kreshnik Myftari: Lidhur më idenë që ua prezantova e bëmë konceptin, të cilin e prezantua pranë universitetit dhe revistës së mirënjohur studentore për çështje ekonomike "Junge Karriere". Koncepti ynë u mirëprit kështu që vazhduam me realizimin e idesë, punë kjo që zgjati një vit. Kështu, tash mund të them se jemi të kënaqur me zhvillimin e uebfaqes sonë në jetën studentore.

Zëri i Ditës: Si e ndjen veten që si shqiptar, të jesh një student i dal-

luar dhe i njohur?

Kreshnik Myftari: Jam shumë i lumtur që më është dhënë mundësia të shkollohem këtu në Gjermani, në një vend, në të cilin kushtet janë me siguri shumë më të mira sesa në vende tjera.

Zëri i Ditës: Çfarë do t'i këshillonit studentët shqiptarë këtu në diasporë?

Kreshnik Myftari: Studentët shqiptarë i këshilloj që, në një anë të angazhohen në studime dhe më së shumti në integrimin intelektual në Gjermani, por në anën tjetër që të mos e harrojnë se kush jemi dhe nga jemi. Në vetëm kështu mundemi t'i tregojmë botës së edhe ne dimë dhe mundemi.

Zëri i Ditës: Cilat janë planet tuaja për të ardhmen?

Kreshnik Myftari: Qëllimi im është, së pari natyrisht, përfundimi i suksesshëm i studimeve. Por edhe realizimi i disa projekteve personale siç janë mirëmbajtja e Semester-Books.de si dhe realizimi i projektit të ri "Miss & Mister Campus" në të cilin jam momentalisht i angazhuar si iniciator. Jemi në kërkim të Missit dhe Misterit të fakultetit. Studentëve u është dhënë mundësia që të konkurrojnë dhe ta fitojnë kurorën. Dhe, duke qeshur, Kreshniku për fund thotë: "Shpresojmë që për titullin e Miss Campus do të konkurrojnë edhe bukuroshet shqiptare."